

## sfidat

Në shoqëritë të cilat ballafaqohen me tranzicion politik ose ripajtim dhe rindërtim pas konfliktit, pasiguria rreth fatit të personave të zhdukur, shpesh obstruon procesin e paqes, implementimin e plotë të sundimit të ligjit dhe dobëson besimin tek institucionet demokratike dhe politike. Zgjidhja e fatit të personave të zhdukur, përbën shqetsim kryesor politik i cili është pjesë integrale e zhvillimeve efikase të institucioneve të përgjegjshme dhe të drejta.

## mandati

ICMP përpqet që të sigurojë bashkëpunimin e qeverive dhe autoriteteve tjera për të lokuar dhe identifikuar personat e zhdukur si pasojë e konflikteve të armatosura, armiqsive tjera ose shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe për ti ndihmuar ato që ta bëjnë këtë. ICMP, gjithashtu përkrahë punën e organizatave tjera, në përpjekjet e tyre, inkurajon kyçjen e publikut në aktivitetet e sajë, dhe kontribon në zhvillimin adekuat të shprehjes së kujtimit në nderim të të hdukurve.

## në tërë botën

Aktualisht, me bazë në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, ICMP është e angazhuar në Ballkanin Perëndimorë dhe Lindjen e Mesme, si dhe në ad hoc bazë në rajonet e përfshira nga katastrofat natyrore, si tsunami i cili përfshiu Azinë Jugore dhe SHBA shtetin e Luisianës pas Hurricane Katrina. ICMP gjithashtu, i kontribon përgatitjeve kombëtare dhe planeve për përgjigje ndaj sulmeve terroriste.

## asistenca teknike

ICMP ju ofron qeverive ndihmë teknike në lokimin dhe identifikimin e personave të zhdukur, duke përfshirë edhe përdorimin e kapaciteteve për analizën e AND-së dhe ndihmën mjeko-ligjore në fushat e arkeologjisë dhe antropologjisë. Ndihma teknike e ICMP-së bëhet në bazë të marr[veshjeve të ICMP-së me qeveritë nikoqire ose organizatat të cilat kërkojnë përkrahjen e ICMP-së. Suksesi i ICMP's në zhvillimin e një çasjeje të integruar shkencore të adresimit të çështjes së personave të zhdukur, e bën atë lider në vaancimin e shkenës së mjeksisë ligjore në shërbim të së vërtetës dhe paqes. Nga nëntori i vitit 2001, ICMP ka kryer më shumë se 13 000 identifikime të asistuara nga AND-ja.

## ndërtimi i kapaciteteve

ICMP i ndihmon qeveritë, për të realizuar obligimet e tyre ligjore në lidhje me çështjen e personave të zhdukur dhe kontribon në ndërtimin e kapaciteteve institucionale. ICMP i kontribuon drejtësisë në tranzicion, ofron ndihmë legjislativë dhe shtimin e kapaciteteve të specializuara të mekanizmave ad hoc, si dhe institucionet në sektorin e drejtësisë, duke përfshirë prokurorët, gjykatësit, policing dhe specialistët mjeko-ligjorë. ICMP, gjithashtu përkrahë zhvillimin e rrjetës së organizatave të shoqërisë civile të cilat avokojnë të vërtetën, drejtësinë dhe të drejtat e familjërve të personave të zhdukur.

## bduhma gjykatave

ICMP i është përgjigur kërkesave për dokumentim dhe raporte ekspertësh, nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore, në çështjet e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, gjenocidit dhe krimeve tjera nën ligjin ndërkombëtarë, në përputhje me ruajtjen e të dhënave në kuadër të politikave të ICMP-së.

## historia

ICMP është themeluar me iniciativën e Presidentit Amerikan Clinton në vitin, pas samitit të G-7-të, në. ICMP fillimisht është udhëhequr nga ish Sekretari i Shtetit i SHBA, Cyrus Vance, i cili u pasua nga senatori i SHBA Bob Dole. Drejtuesi aktual i ICMP's James V. Kimsey.

## komisionerët

James V. Kimsey, Chair, Kryetar i Kimsey Foundation

Willem Kok, ish Kryeministër i Holandës

Lartmadhërija e sajë Mbretëresha

Rt. Hon. Michael Portillo, ish sekretar i Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, United Kingdom

Ambassador Rolf Ekéus, Komisioner i Iartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare

## fondet

ICMP finansohet nga grantet vullnetare, donacionet dhe kontributet e Qeverive pjesmarrëse duke përfshirë Kanadan, Danimarkën, Finlandën, Francën, Gjermaninë, Greqinë, Selinë e Shenjtë, Islandën, Irlandën, Itali dhe Mbretërinë e Bashkuar, Polonia, Shtetet e Bashkuara, Bashkimin Europian. Përkrahje për projekte të veçanta është ofruar edhe nga Charles Stewart Mott Foundation.



ICMP  
Alipašina 45a  
71000 Sarajevo  
Bosnia and Herzegovina  
Phone:  
+387 (0) 33 21 86 60  
Fax:  
+387 (0) 33 203 297  
E-mail: [icmp@ic-mp.org](mailto:icmp@ic-mp.org)